LIGJ
Nr. 83/2015

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR BASHKËPUNIMIN FINANCIAR 2011, PËR MASËN SHOQËRUESE TË PROJEKTIT "PROGRAM PËR SEKTORIN E UJIT/PROGRAM PËR FURNIZIMIN E ZONAVE RURALE ME UJË, III"

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar 2011, për masën shoqëruese të projektit "Program për sektorin e ujit/program për furnizimin e zonave rurale me ujë, III", sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji dhe pjesëve përbërëse të tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 23.7.2015

Shpallur me dekretin nr. 9195, datë 30.7.2015 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

MARRËVESHJE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR BASHKËPUNIMIN FINANCIAR 2011, PËR MASËN SHOQËRUESE TË PROJEKTIT "PROGRAM PËR SEKTORIN E UJIT/PROGRAM PËR FURNIZIMIN E ZONAVE RURALE MË UJË III"

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë,

në frymën e marrëdhënieve ekzistuese miqësore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë;

duke u nisur nga dëshira për t'i forcuar dhe thelluar këto marrëdhënie miqësore nëpërmjet Bashkëpunimit Financiar si partnerë; të ndërgje-gjshme se ruajtja e këtyre marrëdhënieve përbën bazën e kësaj marrëveshjeje;

me qëllim për të kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë;

duke iu referuar premtimit të Ambasadës së Republikës Federale të Gjermanisë (notë verbale nr. 197/2011, e datës 23 nëntor 2011) dhe protokollit të bisedimeve ndërqeveritare, të datës 8 maj 2014,

kanë rënë dakord si vijon:

Neni 1

1. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Shqipërisë ose

marrësve të tjerë, të cilët do të zgjidhen bashkërisht nga të dyja Qeveritë, të marrin nga Kreditanstalt für Wiederaufbau (KfW) një shumë financimi me vlerë prej deri në 1 500 000 eurosh (me një fjalë: një milion pesëqind mijë euro) për masa të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit "Program për sektorin e ujit/program për furnizimin e zonave rurale me ujë III", nëse nga shqyrtimi përkatës ka rezultuar se masat në fjalë vlejnë për t'u mbështetur dhe është konfirmuar se ato plotësojnë kushtet e posaçme për mbështetjen nëpërmjet një shume financimi, duke qenë masa në fushën e përmirësimit të pozitës shoqërore të grave ose masa për luftimin e varfërisë, duke u mbështetur në parimin e vetëndihmës, ose fonde garantuese të kredive për ndërmarrje të mesme, ose projekte në fushën e infrastukturës sociale ose të mbrojtjes së mjedisit.

2. Po të bien dakord Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë dhe Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë, projekti i përmendur në paragrafin 1 mund të zëvendësohet me projekte të tjera. Në rast se projekti zëvendësohet me një projekt, i cili plotëson kushtet e posaçme për mbështetjen nëpërmjet një shume financimi, duke qenë një projekt në fushën e mbrojtjes së mjedisit ose të infrastrukturës sociale ose një fond garantues i kredive për ndërmarrje të mesme, ose një masë për luftimin e varfërisë, duke u mbështetur në parimin e vetëndihmës, ose një masë, e cila i shërben përmirësimit të pozitës shoqërore të grave, atëherë mund të akordohet një shumë financimi, në të kundërt mund të jepet një hua.

3. Në rast se Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë në një kohë të mëvonshme i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të marrë nga Kreditanstalt für Wiederaufbau hua ose shuma të tjera financimi për përgatitjen e projektit të përmendur në paragrafin 1 ose shuma të tjera financimi për masa të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit të përmendur në paragrafin 1, gjen zbatim kjo marrëveshje.

4. Shumat e financimit për masa përgatitore dhe shoqëruese do të kthehen në hua, në rast se ato nuk përdoren për masa të tilla.

Neni 2

1. Përdorimi i shumës së përmendur në nenin 1, kushtet me të cilat vihet në dispozicion ajo, si dhe procedura e dhënies së porosisë përcaktohen në kontratat që do të përfundohen midis Kreditanstalt für Wiederaufbau dhe marrësve të huas dhe të shumës së financimit, të cilat u nënshtrohen dispozitave ligjore që janë në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë.

2. Premtimi i shumës së përmendur në nenin 1 do të zhvleftësohet, në rast se kontratat përkatëse për financim nuk lidhen brenda një afati prej tetë vjetësh pas vitit të premtimit. Për këtë shumë, ky afat mbaron në datën 31 dhjetor 2019.

3. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ai vetë nuk është marrësi i shumës së financimit, do të garantojë ndaj Kreditanstalt für Wiederaufbau pretendimet e mundshme për shlyerjen, që mund të lindin në bazë të kontratave për financim, të cilat do të lidhen sipas paragrafit 1.

Neni 3

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e liron Kreditanstalt für Wiederaufbau nga të gjitha tatimet dhe taksat e tjera publike, të cilat merren në Republikën e Shqipërisë lidhur me përfundimin dhe zbatimin e kontratave të përmendura në nenin 2, paragrafi 1.

Neni 4

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i lejon pasagjerët dhe furnizuesit të zgjedhin lirisht ndërmarrjet transportuese për transportimin e personave dhe të mallrave në rrugë detare, tokësore dhe ajrore, transport ky që rezulton nga dhënia e huas dhe e shumave të financimit, si dhe nuk merr asnjë masë, e cila përjashton ose vështirëson pjesëmarrjen me të drejta të barabarta të ndërmarrjeve

transportuese me seli në Republikën Federale të Gjermanisë, dhe nxjerr sipas rastit lejet e nevojshme për pjesëmarrjen e këtyre ndërmarrjeve transportuese.

Neni 5

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën, kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i njofton Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, se janë përmbushur kushtet brendashtetërore për hyrjen në fuqi. Përcaktuese është dita e marrjes së njoftimit.

Bërë në Tiranë, _____, në dy origjinale, secila në gjuhën shqipe dhe gjermane, duke pasur të dyja tekstet fuqi të barabartë.